



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

RREGULLORE

Nr. 27, Datë 30.10.2020

**PËR SISTEMIN E VLERËSIMIT TË REZULTATEVE TË PUNËS DHE
INTEGRITETIT TË OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE .
(E përditësuar datë 07.04.2023)**

Në mbështetje të Nenit 10, pika 1, shkronja “d”, Nenit 29, pika 7 dhe nenit 41, pika 3, të Ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”,

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE MIRATON KËTO RREGULLA:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti i rregullores

1. Objekti i kësaj rregulloreje është hartimi i një sistemi objektiv vlerësimi dhe përcaktimi i rregullave dhe parametrave të nevojshëm për mënyrën e vlerësimit periodik të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore gjatë ushtrimit të funksionit të oficerit të policisë gjyqësore.
2. Nëpërmjet rregullave të parashikuara në këtë rregullore, synohet të sigurohet një mënyrë efikase për vlerësimin e performancës së oficerëve të policisë gjyqësore, duke inkurajuar një nivel më të lartë të motivimit dhe pjesëmarrjes më gjerësisht të oficerëve të policisë gjyqësore në ushtrimin e funksionit të tyre.

Neni 2

Qëllimi i vlerësimit

1. Vlerësimi periodik i rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore ka për qëllim dhe synon:
 - a) Të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësitë profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore;
 - b) Të ndikojë në rritjen e përgjegjësisë së oficerëve të policisë gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre;
 - c) Ndikimin e drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë (qëndrimin në një vend pune) dhe promovimin e oficerëve të policisë gjyqësor;
 - d) Të vendosë standarte të qëndrueshme për cilësinë dhe ngarkesën në veprimtarinë e oficerëve të policisë gjyqësore;
 - e) Identifikimin e mangësive profesionale dhe nevojat për trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore si dhe identifikimin e elementëve të paaftë brenda trupës së oficerëve të policisë gjyqësore;
 - f) Për të shpërblyer oficerët e policisë gjyqësore që kanë merita profesionale dhe tregues efektivë në ushtrimin e funksioneve.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregullore do të zbatohen për vlerësimin e rezultateve në punë dhe integritetin e :

1. Oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë.
2. Oficerëve të policisë gjyqësore që janë pjesë e Strukturës Hetimore të ngritur si pjesë e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Policisë së Shtetit.
3. Oficerëve të Policisë Gjyqësore të shërbimeve të tjera të Policisë Gjyqësore të ngritura në Policinë Ushtarake, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të angazhuar nga prokurori në hetimin e procedimeve penale.

Neni 4

Periudha, mënyra dhe forma e vlerësimit të rezultateve

1. Vlerësimi i rezultateve individuale të oficerëve të policisë gjyqësore kryhet për çdo vit pune.
 2. Në funksion të një vlerësimi të saktë dhe objektiv, drejtuesit e prokurorive marrin masat e nevojshme nëpërmjet administratës së institucionit, për të evidentuar në mënyrë statistikore numrin e procedimeve penale të hetuara gjatë vitit nga oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore. Prokurorët duhet të plotësojnë në çdo fund viti, pasqyra të sakta me emrat e oficerëve që kanë angazhuar gjatë vitit me hetimin e procedimeve penale, numrin e procedimeve penale që ka hetuar secili oficer i policisë gjyqësore dhe problematikat, parregullsitë dhe shkeljet e kryera prej tyre.
- 2.1. *Drejtuessi i prokurorisë është ai drejtues, ku oficeri i Policisë Gjyqësore që vlerësohet ka ushtruar aktivitetin gjatë periudhës së vlerësimit.*

Drejtuesi i prokurorisë është përgjegjës për:

- a) *Të dhënat statistikore dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në këtë rregullore, që administrohen nga prokuroria ku ai është drejtues dhe janë në kompetencën e tij, të cilat janë të nevojshme për një vlerësim të drejtë dhe objektiv të punës dhe integritetit të oficerëve të Policisë Gjyqësore.*
- b) *b) Kryerjen e vlerësimit të drejtë dhe objektiv të punës dhe integritetit të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe dërgimin e vlerësimeve në Komisionin e Policisë Gjyqësore brenda afatit të caktuar në rregullore..*

Vlerësimi për oficerët e Policisë Gjyqësore, të cilët gjatë vitit të vlerësimit, e kanë ushtruar aktivitetin e tyre në prokurori të ndryshme, bëhet nga drejtuesi i prokurorisë ku oficeri i Policisë Gjyqësore ka ushtruar aktivitetin për periudhë më të madhe.

3. *Çdo vit, brenda muajit prill, Drejtuesi i Prokurorisë, pasi ka marrë dhe mendimin me shkrim nga prokurorët, i paraqet Komisionit të Policisë Gjyqësore vlerësimin e rezultateve të punës për oficerët e policisë gjyqësore.*
4. *Vlerësimi i rezultateve të punës të oficerit të policisë gjyqësore bëhet, duke vlerësuar të gjithë elementët dhe fazat në të cilat kalon procesi i punës së tij.*
5. *Vlerësimi nga drejtuesi i prokurorisë, përgatitet në formë të shkurtër përshkruese dhe statistikore, sipas një sistemi pikëzimi, duke u mbështetur në **Aneksin 1 dhe 2**, të cilat janë pjesë integrale dhe të pandashme të Rregullores.*

***Aneksi 1** përmban metodologjinë e pikëzimit të treguesve të punës dhe integritetit të oficerëve të Policisë Gjyqësore që përdoret për të përcaktuar nivelin e vlerësimit për secilin kriter dhe tregues përkatës të parashikuar në sistemin e vlerësimit. Sipas Aneksit 1, drejtuesi i Prokurorisë përshkruan veprimtarinë e oficerit të policisë gjyqësore, duke bërë një vlerësim të përgjithshëm si dhe duke u shprehur për secilin tregues të punës dhe mangësit profesionale dhe etike të cilat janë të rëndësishme për një vlerësim të drejtë dhe objektiv.*

***Aneksi 2**, është në formë pasqyre apo tabele dhe plotësohet nga drejtuesi i prokurorisë. Aneksi 2 përmban vlerësimin me pikë që drejtuesi i prokurorisë bën për treguesit e punës së oficerit të policisë gjyqësore. Vlerësimi shoqërohet me treguesit e volumit, cilësisë dhe shpejtësisë në hetim, sipas Aneksit 3*

***Aneksi 3**, është në formë tabele dhe përmban të gjithë treguesit e punës dhe aktivitetit të oficerit të policisë gjyqësore gjatë vitit. Aneksi 3 plotësohet nga vetë oficeri i policisë gjyqësore, por duhet të verifikohet dhe miratohet nga drejtuesi i prokurorisë për vërtetësinë e të dhënave që paraqet.*

Me qëllim lehtësimin e këtij procesi, oficeri i Policisë Gjyqësore, çdo muaj plotëson formularin e Aneksit 3, të cilin e administron vetë. Në fund të muajit dhjetor, oficeri i

policisë gjyqësore plotëson formularin e Aneksit 3 me të dhënat përfundimtare dhe ja dorëzon drejtuesit të prokurorisë.

Bashkë me Aneksin 3, të plotësuar, oficeri i Policisë Gjyqësore i dorëzon drejtuesit dhe dokumenta apo praktika të trajtuara prej tij dhe që nuk kanë lidhje me hetimin si dhe dokumenta që tregojnë përmarrjen e tij në aktivitete trajnuese apo publikime të ndryshme për periudhën e vlerësimit“.

6. Në formularin e **Aneksit 2**, Drejtuesi i Prokurorisë përshkruan veprimtarinë e oficerit të policisë gjyqësore, duke bërë një vlerësim të përgjithshëm si dhe duke u shprehur për secilin tregues të punës dhe mangësitë profesionale dhe etike, të cilat janë të rëndësishme për një vlerësim të drejtë dhe objektiv.

Drejtuesi i prokurorisë duhet të japë shpjegime dhe të argumentojë vlerësimin e bërë për oficerin e Policisë Gjyqësore.” Shpjegimi dhe argumentimi duhet të bëhet për të katër kriteret e vlerësimit, aftësitë profesionale, aftësitë organizative, aftësitë personale dhe angazhimi profesional, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale“.

7. Vlerësimi i përgatitur nga Drejtuesi i prokurorisë i paraqitet oficerit të policisë gjyqësore që vlerësohet.

Oficeri i policisë gjyqësore duhet ta nëshkruaj raportin e vlerësimit brenda 5 ditëve, dhe kur nuk është dakort, brenda këtij afati duhet të paraqes me shkrim kundërshtimet dhe argumentet e tij.

8. Drejtuesi i prokurorisë, kryen verifikimet e nevojshme dhe kur i gjen të bazuara kundërshtimet e oficerit të policisë gjyqësore, bënë korigjimet e nevojshme në raportin e vlerësimit. Në rast se drejtuesi i prokurorisë vlerëson se kundërshtimet nuk janë të bazuara, njofton me akt të shkruar oficerin e policisë gjyqësore duke arsyetuar shkaqet e mospranimit të kundërshtimeve.

Kundër vlerësimit dhe aktit të drejtuesit të prokurorisë që refuzon pretendimet, oficeri i policisë gjyqësore mund të ankohet në Komisionin e Policisë Gjyqësore.

9. Pasi kryen verifikimin e pretendimeve të oficerit të policisë gjyqësore, Drejtuesi i prokurorisë aktet për vlerësimin e rezultateve në punë të oficerit të policisë gjyqësore shoqëruar me kundërshtimet e oficerit të policisë gjyqësore, ia dërgon Komisionit të Policisë Gjyqësore.

Akteve të vlerësimit, përveç Anekseve, 1, 2 dhe 3, duhet ti bashkangjiten dhe pasqyrat me të dhënat statistikore mbi ngarkesën e punës dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve, të oficerëve të Policisë Gjyqësore, të nxjerë nga regjstrat elektronike dhe fizikë të Zyrës së regjistrimit.

10. “ Komisioni i Policisë Gjyqësore, pasi shqyrton dhe vlerëson aktet e vlerësimit të dërguara nga drejtuesi i prokurorisë për vlerësimin e oficerit të Policisë Gjyqësore, ankimin e oficerit të Policisë Gjyqësore, kur ka të tillë, dhe pasi kryen verifikimet e nevojshme, bën vlerësimin përfundimtar të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerit të Policisë Gjyqësore. Në funksion të kryerjes së këtij procesi, Komisioni mund të kërkojë të dhëna shtesë nga drejtuesi i prokurorisë.

Për kryerjen e vlerësimit, Komisioni analizon në mënyrë të detajuar të dhënat dhe aktet që paraqiten nga drejtuesi i prokurorisë bashkë me aktin e vlerësimit . Komisioni analizon të dhënat statistikore të paraqitura dhe mënyrën e pikëzimit të bërë nga drejtuesi i prokurorisë për kriteret dhe nënkriteret e vlerësimit. Analiza e të dhënave statistikore për ngarkesën në punë të oficerit të Policisë Gjyqësore dhe rendimentin e përfundimit të çështjeve, kohëzgjatjen e hetimeve, bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve të hetuara nga seksioni i Policisë Gjyqësore ku oficeri i Policisë Gjyqësore bënë pjesë, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës.

Në rastet kur Komisioni, vlerëson se pikëzimi i kriterëve dhe nënkriterëve të bëra nga drejtuesi i prokurorisë nuk përputhet me të dhënat statistikore të paraqitura dhe aktet që shoqërojnë vlerësimin, bën vlerësim të ri, të ndryshëm nga ai i drejtuesit të prokurorisë. Arsyet e vlerëzimit ndryshe nga Komisioni pasqyrohen në vendimin përfundimtar të vlerësimit të Komisionit.

Neni 5

Klasifikimi i vlerësimit të oficerëve të policisë gjyqësore.

1. *Komisioni i Policisë Gjyqësore bazuar në vlerësimet e paraqitura nga drejtuesi i prokurorisë dhe vlerësimi i kryer prej vetë Komisionit, bën klasifikimin e vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore sipas përcaktimeve të parashikuara në pikën 3 të nenit 29 të ligjit nr.25/2019 “për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore“.*
2. Vlerësimi kryhet sipas këtyre niveleve:
 - a) “ I paaftë”
 - b) “Mjaftueshëm”
 - c) “Mirë”
 - d) “Shumë mirë”
 - a) Vlerësimi i përgjithshëm “ **I paaftë** ” jepet në rastet kur shuma e pikëve të mbledhura për të katër kriteret është jo më shumë se 30 pikë.
 - b) Vlerësimi i përgjithshëm “**Mjaftueshëm**” jepet në rastin kur shuma e pikëve të mbledhura për të katër kriteret është nga 31 deri në 50 pikë.
 - c) Vlerësimi i përgjithshëm “ **Mirë** ” jepet në rastin kur shuma e pikëve të mbledhura për të katër kriterëve është nga 51 deri në 80 pikë.
 - d) Vlerësimi i përgjithshëm “**Shumë mirë**” jepet kur shuma e pikëve të mbledhura për të katër kriteret është nga 81 deri në 100 pikë.
3. *Në kryerjen e vlerësimit përfundimtar, drejtuesi i prokurorisë dhe Komisioni duhet të marrin në konsideratë faktin nëse gjatë periudhës për të cilën bëhet vlerësimi, ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore është dhënë masë disiplinore.*

Në rastet kur ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore që vlerësohet është dhënë masë disiplinore, nga shumatorja e pikëve që i janë dhënë gjatë vlerësimit me pikë për kriteret e vlerësimit, i zbriten një numër i caktuar pikësh, në varësi të lloit të masës disiplinore.

Kur ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore është dhënë masa disiplinore, vërejtje me shkrim ose vërejtje me paralajmërim, nga shumatorja e pikëve të grumbulluara, zbriten 20 pikë.

Për rastet e dhënies së masave të tjera disiplinore, të parashikuara nga neni 34 i Ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore“, nga shumatorja e pikëve të grumbulluara, zbriten 30 pikë.

4. Aktet e vlerësimit të oficerëve të policisë gjyqësore, u dërgohen drejtuesve të institucioneve ku oficeri i policisë gjyqësore bën pjesë. Vlerësimi i shërben zhvillimit të karrierës së oficerëve të policisë gjyqësore.
5. Aktet e vlerësimit bëhen pjesë e dosjes personale të oficerit të policisë gjyqësore.

Neni 6

Niveli i vlerësimit

1. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit, përfshin të gjithë kriteret e vlerësimit dhe përcaktohet mbi bazën e një shkallë pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.
2. Para se të kryet përcaktimi i nivelit të përgjithshëm të vlerësimit, bëhet vlerësimi oficerit të policisë gjyqësore për secilin nga kriteret e vlerësimit.
3. Niveli i vlerësimit për secilin nga kriteret e vlerësimit, përcaktohet mbi bazën e një shkalle pikëzimi. Shkalla dhe maksimumi i pikëve për çdo kriter vlerësimi përcaktohen mbi bazën e rëndësisë dhe peshës që ka secili kriter në evidentimin e aftësive dhe integritetit të oficerit të policisë gjyqësore, por shuma totale e pikëve të caktuara për kriteret nuk duhet të jetë më shumë se 100 pikë.
4. Shkalla e pikëzimit që përcakton nivelet e vlerësimit do të jetë:
81 deri në 100 pikë “Shumë mirë”;
51 deri në 80 pikë “Mirë”;
31 deri në 50 pikë “Mjaftueshëm”;
32 deri në 01 pikë “ I paaftë”;
5. Brenda çdo kriteri vlerësimi bëhet ndarja e pikëve sipas rëndësisë së çdo treguesi vlerësimi.
6. Ndarja e kriterëve të vlerësimit, lista e aspekteve të çdo kriteri, treguesit e vlerësimit dhe pikëzimi i tyre sipas nivelit, në funksion të pikëzimit dhe të vlerësimit final të oficerit të policisë gjyqësore do të bëhet sipas tabelës së pikëzimit, pjesë e **Aneksit 2** të kësaj rregullore.

Neni 7

Burimet e vlerësimit

Vlerësimi i oficerëve të policisë gjyqësore do të bazohet në dokumentat dhe burimet e mëposhtme:

- a) dosja personale e oficerit të policisë gjyqësore;
- b) të dhënat statistikore, në lidhje me procedimet penale, të cilat, duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha procedimet penale të hetuara nga oficeri i policisë gjyqësore.
- c) mendimi i prokurorëve;

- d) mendimi dhe të dhënat e drejtuesve të institucioneve të emërtesës së oficerit të policisë gjyqësore.
- e) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj oficerit të policisë gjyqësore gjatë periudhës së vlerësimit;
- ë) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë ose institucione të tjera, i cili, vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e oficerit të policisë gjyqësore në veprimtaritë trajnuese;
- f) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj oficerit të policisë gjyqësore;
- g) kundërshtimet e oficerit të policisë gjyqësore;
- gj) Aneksi 3 i plotësuar nga oficeri i policisë gjyqësore. Me qëllim plotësimin e saktë të Aneksit 3, u rekomandohet oficerëve të policisë gjyqësore të mbajnë të dhënat sipas formatit të aneksit 3 çdo muaj dhe kjo do t'iu shërbejë atyre për plotësimin përfundimtar, vjetor të këtij aneksi.
- h) Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të oficerit të policisë gjyqësore.

Neni 8

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i rezultateve të punës së oficerëve të policisë gjyqësore bëhet sipas kriterëve të më poshtme:

- a) Aftësitë profesionale.
- b) Aftësitë organizative.
- c) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
- ç) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale.

Neni 9

Kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale.

Vlerësimi i aftësive profesionale të oficerit të policisë gjyqësore përfshin:

- a) Njohuritë ligjore bazuar në aftësitë për të hetuar dhe marrë vendime, aftësia e përgjithshme për të ndërmarë logjikisht hetimin sipas kërkesave të ligjit, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe interpretuar ligjin, Arsytimin ligjor në nxjerjen e akteve dhe kryerjen e veprimeve hetimore, bazuar në qartësinë dhe kuptueshmërinë e aktit, strukturën e tij, aftësinë për të marrë në pyetje, cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të oficerit të policisë gjyqësore.
- b) Volumi i punës, ngarkesa që ka përballuar oficeri i policisë gjyqësore.
- c) Cilësia në hetim, raporti midis dosjeve të dërguara gjyqit dhe atyre të pushuara dhe pezulluara, raporti midis akteve të nxjerra nga oficeri i policisë gjyqësore me ato të deklaruar të pavlefshme nga prokurori, respektimi i ligjit gjatë aplikimit të masave të ndalimit me inisiativë dhe arrestit në flagrancë. Sa prej tyre janë shpallur të paligjshme nga prokurori
- d) Zbatimi i metodave speciale të hetimit.
- e) Aftësia për të kryer detyrat e dhëna në përputhje me vështirësitë, kompleksitetin apo lehtësinë që shfaqet për çdo rast konkret dhe aftësia në zbatimin e urdhërave, e cila,

nënkupton aftësinë për të kryer në mënyrë efektive çdo veprim hetimor që është urdhëruar apo deleguar nga prokurori.

Neni 10

Kriteret e vlerësimit të aftësive organizative

Vlerësimi i aftësive organizative përfshin:

- a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë.
- b) Aftësia për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore dhe procedura të tjera.
- ç) Aftësia për të administruar dosjet penale.

Neni 11

Kriteret e vlerësimit të aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimi profesional përfshin:

- a) Aftësitë e komunikimit.
- b) Aftësitë për të bashkëpunuar me kolegët.
- c) Gadishmëria për tu angazhuar në veprimtari të tjera.

Neni 12

Kriteret e vlerësimit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale

Vlerësimi i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale përfshin:

- a) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në ushtrimin e funksionit, ndërgjegjësimi i tij, ndjenja e detyrës dhe përgjegjësisë.
- b) Integriteti, shmangia e sjelljeve të pahijshme që lidhen me nderin dhe dinjitetin.
- c) Paanësia në hetimin e çështjeve ku përfshihen:

Neni 13

Vlerësimi i prgjithshëm “Shumë mirë”

Me qëllim motivimin dhe rritjen e përgjegjshmërisë së oficerëve të policisë gjyqësore, Komisioni i Policisë Gjyqësore nga oficerët e policisë gjyqësore të vlerësuar “shumë mirë” përzgjedh 20% të tyre, të cilët, janë vlerësuar me më shumë pikë dhe ja rekomandon drejtuesve të institucioneve përkatëse, për ti promovuar dhe shpërblyer financiarisht. Masa e shpërblimit vendoset nga drejtuesi i institucionit që ka në emërtesë oficerin e policisë gjyqësore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë shpërblimin për merita profesionale.

Neni 14

Vlerësimi i përgjithshëm “I paaftë”

1. Në rastet e vlerësimit të përgjithshëm, “I paaftë”, kur Komisioni i Policisë Gjyqësore, konstaton se mangësitë profesionale të oficerit të policisë gjyqësore mund të plotësohen, vendos që oficeri i policisë gjyqësore ti nënshtrohet një programi të veçantë trajnimi. Programi dhe afati i trajnimit vendoset me marveshje midis Komisionit të Policisë Gjyqësore, Prokurorit të Përgjithshëm, Akademisë së Sigurisë dhe Drejtuesit të Institucionit, në emërtesë të cilit, është oficeri i policisë gjyqësore.

2. Në rastet kur mangësitë profesionale të oficerit të policisë gjyqësore janë të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet trajnimit, vlerësimi i përgjithshëm i “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës disiplinore për shkarkimin nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 29, pika 4 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

3. Në këto raste, Komisioni i Policisë Gjyqësore njofton me rezultatet e vlerësimit titullarin e institucionit shtetëror, ku oficeri i policisë gjyqësore bën pjesë dhe i kërkon atij, që mbështetur në kërkesat e nenit 35, pika 2 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, të kërkojë fillimin e procedurës disiplinore, ndaj oficerit të policisë gjyqësore, i cili, është vlerësuar “I paaftë”.

Neni 15 **Dispozita zbatuese**

Për zbatimin e kësaj rregullore ngarkohen, Komisioni i Policisë Gjyqësore, Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, prokurorët e këtyre prokurorive, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet shtetërore, të cilave, ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore, për atë që rregullat e përcaktuara në këtë rregullore janë të zbatueshme prej tyre.

Neni 16 **Dispozita kalimtare**

Deri sa institucionet e tjera, të cilave, ligji organik apo i posaçëm, u njeh ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore, dhe ngritjen e shërbimeve të policisë gjyqësore, deri në ngritjen e tyre, sipas parashikimeve të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, vlerësimi i rezultateve në punë dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore do vazhdojë të kryhet nga institucionet e emërtesës së oficerëve të policisë gjyqësore, bazuar në sistemin e vlerësimit të parashikuar në rregulloret apo aktet nënligjore të këtyre institucioneve.

Neni 17 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Komisioni i Policisë Gjyqësore.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI

ANËTAR

ARJAN MUÇA

ANËTAR

HARI GOGO

ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO